



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AGJENCISË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të AKKVP kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtoresha Ekzekutive është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtoresha Ekzekutive është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtoresha Ekzekutive është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit kemi identifikuar fusha me mundësi përmirësimi, përfshirë aspektet e kontrollit të brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë më shumë fokus gjatë kësaj periudhe lidhen me menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive, për shkak të mangësive të identifikuara në evidentimin dhe përditësimin e tyre në regjistrat përkatës. Në këtë kontekst, kërkohet vëmendje e shtuar në adresimin dhe implementimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga komisioni i inventarizimit, me qëllim sigurimin e një pasqyrimi të saktë dhe të plotë të pasurive.

Po ashtu, kërkohet përmirësim në procesin e hartimit të kërkesave dhe dokumentacionit në dosjet e tenderit, veçanërisht gjatë kontraktimit të konsulentëve individualë, me qëllim sigurimin e qartësisë, transparencës dhe përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi.

Ky raport përmban gjithsej tri rekomandime të reja.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë

Buxheti final për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2025 ishte 833,491€, nga i cili janë shpenzuar 796,961€. Këto shpenzime lidhen kryesisht me qiratë, mirëmbajtjen, shërbimet kontraktuese si dhe shpenzimet e tjera administrative.

Çështja A1 - Mangësi në procedurat e prokurimit për angazhimin e kontraktorëve individualë për shërbime të veçanta

Gjetja

Neni 52 i Ligjit të Prokurimit Publik, specifikon se vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues duhet të sigurojë që të bëjë një dallim të qartë në mes kriterëve të vlerësimit dhe kriterëve të përzgjedhjes në lidhje me aftësitë e përgjithshme profesionale, financiare dhe teknike të themeluara në bazë të nenit 51 të këtij ligji dhe se nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive të kriterëve.

Tutje, neni 57 i Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022 me plotësim ndryshime përcakton se ky nen aplikohet vetëm për prokurimin e Shërbimeve të veçanta, të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Zyrtarët Publik, pas marrjes së konfirmimit nga njëسيا e personelit që pozitë e kërkuara për kontraktim individual nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit. Po ashtu, në këtë nen përcaktohet se kontraktimi i Kontraktorëve Individual bëhet përmes procedurave të prokurimit, duke përfshirë Procedurat e Kuotimit të Çmimeve dhe Procedurat me vlerë minimale, dhe duke përdorur kriterin e shpërblimit të kontratës publike për shërbime tenderi ekonomikisht më i favorshëm.

Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit kemi identifikuar se në shtatë ¹ raste të angazhimit të kontraktorëve individual përmes procedurave për shërbime të veçanta, autoriteti kontraktues nuk ka bërë ndarje të qartë ndërmjet kriterëve të përzgjedhjes dhe atyre të dhënies së kontratës në dosjen e tenderit. Kriteret e përzgjedhjes janë përdorur edhe si kriterë të dhënies, në kundërshtim me kërkesat ligjore, të cilat përcaktojnë se kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdoren si kriterë të dhënies në rastet kur aplikohet kriteri tenderi ekonomikisht më i favorshëm.

Përveç kësaj, si nën-kriterë të dhënies janë përdorur kualifikimi, përvoja dhe cilësia e metodologjisë së propozuar, mirëpo nuk janë definuar qartë parametrat matës për ndarjen e pikëve ndërmjet ofertuesve me nivele të ndryshme të kualifikimit, përvojës dhe cilësisë së metodologjisë së punës, si dhe mungojnë intervalet e pikëzimit dhe elementet konkrete të vlerësimit, çka pamundëson një vlerësim të krahasueshëm dhe objektiv të ofertave. Për më tepër, është evidentuar se në tri raste shërbimet e kontraktuara përmes konsulentëve lidhen me pozita të parapara në rregulloren e brendshme për sistematizimin e vendeve të punës (Ekspert Ligjor, konsulent për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, si dhe konsulent për Integrimin e Infrastrukturës Kompjuterike), pa u bërë një vlerësim i mjaftueshëm i nevojës për mbulimin e tyre përmes stafit të rregullt.

Këto mangësi kanë rezultuar për shkak të paqartësive në zbatimin e kërkesave ligjore nga njësia e prokurimit gjatë përgatitjes së dosjeve të tenderit, si dhe mungesës së kontrolleve efektive në rishikimin e tyre. Ndërsa, angazhimi i konsulentëve përmes procedurave të prokurimit për pozita të ngjashme me ato të parapara në rregulloren e brendshme të sistematizimit ka ndodhur për shkak të mungesës së një vlerësimi gjithëpërfshirës mbi mënyrën më të përshtatshme të mbulimit të këtyre nevojave.

Ndikimi

Përdorimi i kritereve të përzgjedhjes si kritere për dhënien e kontratës dhe mungesa e kritereve të matshme rrit rrezikun për trajtim jo të barabartë të ofertuesve, duke ndikuar që të mos përzgjidhet oferta me vlerën më të mirë për para dhe të mos sigurohet shfrytëzim efikas i fondeve publike. Për më tepër, angazhimi i konsulentëve përmes procedurave të prokurimit për pozita të parapara me rregulloren e brendshme ² si vende të rregullta pune anashkalon proceset e rekrutimit dhe dobëson menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve njerëzore.

Rekomandimi A1

Drejtoresha Ekzekutive duhet të sigurojë që në dosjet e tenderit të bëhet ndarje e qartë ndërmjet kritereve të përzgjedhjes dhe atyre të dhënies, si dhe që kriteret e dhënies të jenë të matshme, me parametra dhe intervale të qarta të pikëzimit, për të garantuar vlerësim objektiv. Po ashtu, të rishikohen në mënyrë sistematike pozitat që aktualisht mbulohen përmes konsulentëve, veçanërisht ato të parapara në rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës, dhe të sigurohet që angazhimi i tyre të bëhet vetëm në raste të justifikuara, kur këto shërbime nuk mund të mbulohen përmes procedurave të rregullta të rekrutimit, me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë institucionale dhe reduktimin e varësisë nga angazhimet e përkohshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 729,206€, pasurive jokapitale është 43,154€, si dhe e stoqeve 26,494€.

Çështja A2 - Klasifikimi i gabuar dhe mos raportim i plotë i pasurive në PFV

Gjetja Sipas Rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, në nenin 6, paragrafët 2 dhe 3, përcaktohet se regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale (me vlerë individuale mbi 1,000 € dhe afat përdorimi më shumë se një vit), pasuritë jo kapitale (me vlerë individuale më të vogël se 1,000 € dhe afat përdorimi më shumë se një vit), si dhe stoqet. Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-Pasuria”.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se AKKVP, ka regjistruar dy pajisje në vlerë totale prej 2,919€ në sistemin “e-Pasuria” nën 1,000€, ndonëse sipas kërkesave rregullative këto duhet të trajtohen si pasuri kapitale dhe të regjistrohen në SIMFK. Për pasojë, gjatë gjenerimit të raportit nga sistemi “e-Pasuria”, i cili përfshin vetëm pasuritë nën 1,000€, këto pajisje nuk janë reflektuar në raportin e pasurive. Si rrjedhojë, këto pajisje nuk figurojnë në regjistrat përkatës dhe nuk janë paraqitur në pasqyrat financiare.

Kjo ka ndodhur për shkak se blerja e tyre është realizuar nga kodet e mallrave dhe shërbimeve, dhe si rrjedhojë janë trajtuar dhe regjistruar si pasuri jo kapitale në sistemin “e-Pasuria”. Sipas zyrtarit të pasurisë, ky trajtim është ndikuar edhe nga sqarimet të pranuar nga Thesari, të cilat janë interpretuar në atë mënyrë që klasifikimi i pasurive të ndërlidhet me kodin buxhetor të shpenzimit, e jo me vlerën dhe kriteret e përcaktuara në rregullore.

Ndikimi Realizimi i pagesave për pajisje me vlerë mbi 1,000€ nga kategoria mallra dhe shërbime ka ndikuar në paraqitje jo të saktë të shpenzimeve dhe njëkohësisht në regjistrim të gabuar të tyre në sistemin e pasurive, duke mos u përfshirë si duhet në regjistrat përkatës dhe në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A2 Drejtoresha Ekzekutive duhet të sigurojë që të ndërmerren veprime për korigjimin e rasteve të identifikuara, në mënyrë që pasuritë të paraqiten saktë në regjistra dhe në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos harmonizimi i gjendjes së pasurive me rezultatet e raportit të inventarizimit**Gjetja**

Sipas nenit 18, paragrafi 3 të Rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, organizatat buxhetore janë të obliguara që së paku një herë në vit të kryejnë inventarizimin e pasurisë jo financiare, me qëllim të verifikimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të saj, ndërsa neni 19, paragrafi 4.7, përcakton se raporti i inventarizimit duhet të përgatitet në kohë të përshtatshme, përpara përgatitjes së pasqyrave financiare, në mënyrë që të mundësohet reflektimi i saktë i gjendjes së pasurisë. Më tej, sipas nenit 24, paragrafi 1 pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurisë jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet jetë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare, ndërsa paragrafi 4 i këtij neni përcakton se pasuria jo financiare jashtë përdorimit nuk duhet të prezantohet në pasqyrat financiare, por duhet të shpaloset në mënyrë të veçantë.

Ne kemi identifikuar se AKKVP nuk kishte arritur të prezantoj saktë pasuritë në PFV për shkak se rezultatet e komisionit të inventarizimit nuk i kishte adresuar dhe nuk kishte bërë harmonizimin e gjendjes së pasurive me raportet e komisionit inventarizues. Me 30.12.2025, komisioni i inventarizimit kishte dorëzuar raportin e tij, në të cilin ishin evidentuar 162 pasuri të paidentifikuara, 609 pasuri të dëmtuara ose jashtë funksionit, si dhe 478 pasuri në proces të shitjes. Pavarësisht gjetjeve të paraqitura nga komisioni, AKKVP nuk kishte ndërmarrë veprime konkrete për trajtimin e tyre, si dhe nuk kishte formuar komisionin e vlerësimit në përputhje me kërkesat e rregullores.

Shkaku i kësaj ka qenë mungesa e qartësisë nga ana e menaxhmentit lidhur me kërkesat e rregullores për kryerjen në kohë të vlerësimit të pasurive, përkatësisht se ky proces duhet të përfundojë para përpilimit të pasqyrave financiare me qëllim harmonizimin e gjendjes së pasurive.

Ndikimi

Mos trajtimi i raportit të komisionit të inventarizimit ka bërë që gjendja reale e pasurive (përfshirë ato të dëmtuara, jashtë funksionit apo të paidentifikuara) të mos harmonizohet me regjistrat, duke rritur rrezikun që vlera e pasurive të mos prezantohet saktë në pasqyra financiare vjetore.

Rekomandimi A3

Drejtoresha Ekzekutive duhet të sigurojë që të bëhet adresimi i çështjeve që identifikohen nga komisioni i inventarizimit dhe të formohet komisioni i vlerësimit në përputhje me kërkesat e rregullores, në mënyrë që gjendja e pasurive të harmonizohet me regjistrat dhe të reflektohet saktë në pasqyrat financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	2,933,439	2,538,103	2,496,573	2,245,976	2,020,804
Grante Qeveritare - Buxheti	2,933,439	2,538,103	2,496,573	2,245,976	2,020,804

Buxheti fillestar për vitin 2025 ishte 2,933,439€, ndërsa buxheti final ishte 2,538,108€, që paraqet një ulje prej 395,336€ krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo ulje ka ndodhur si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore gjatë vitit fiskal 2025.

Shpenzimet totale të realizuara gjatë vitit 2025 ishin 2,496,573€, që përfaqëson rreth 98% të buxhetit final, duke treguar një nivel të lartë të ekzekutimit të buxhetit. Krahasuar me vitin 2024 (2,245,976€), shpenzimet në vitin 2025 janë më të larta për 250,597€.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	2,933,439	2,538,103	2,496,573	2,245,976	2,020,804
Pagat dhe mëditjet	1,602,326	1,479,509	1,479,509	1,246,225	1,202,116
Mallrat dhe shërbimet	851,090	833,491	796,961	746,667	744,730
Komunalitë	48,523	48,523	46,003	38,314	37,178
Investimet Kapitale	431,500	176,580	174,100	214,770	36,780

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për kategorinë “Paga dhe Mëditje”, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i ulët për 122,817€, si rezultat i ndryshimeve buxhetore të realizuara gjatë vitit 2025. Fillimisht, me Vendimin e Qeverisë nr. 03/261, datë 05.06.2025, është aprovuar rritje buxhetore prej 61,833€ për mbulimin e efektit financiar të rritjes së koeficientit të pagave, duke filluar nga muaji korrik 2025. Më pas, në bazë të Vendimit të Qeverisë nr. 01/281, datë 24.12.2025, për zbatimin e masave të kursimeve buxhetore, nga kjo kategori janë tërhequr mjete në vlerë prej 184,650€. Kjo ka ndodhur si pasojë e mosplotësimit të disa pozitave të planifikuara dhe lëvizjeve të stafit gjatë vitit. Buxheti final është realizuar në nivel 100%.
- Buxheti fillestar për kategorinë “Mallra dhe Shërbime” ishte 851,090€, ndërsa buxheti final 833,491€, që paraqet reduktim prej 17,599€, si rezultat i Vendimit të Qeverisë nr. 04/282, datë 24.12.2025, për kursime buxhetore gjatë vitit 2025. Realizimi i shpenzimeve ishte 796,961€, apo rreth 96% e buxhetit final, duke reflektuar ekzekutim brenda kufijve të autorizuar buxhetorë.
- Buxheti fillestar për kategorinë “Shpenzimet Komunale” ishte 48,523€, i cili mbeti i pandryshuar edhe si buxhet final. Realizimi i shpenzimeve në këtë kategori ishte në vlerë prej 46,003€, që përfaqëson rreth 95% të buxhetit final.
- Buxheti fillestar për kategorinë “Investimet Kapitale” ishte 431,500€, ndërsa buxheti final 176,580€, që paraqet reduktim prej 254,920€, si rezultat i Vendimeve të Qeverisë nr. 01/276, datë 24.11.2025 dhe nr. 04/282, datë 24.12.2025, për kursime buxhetore gjatë vitit 2025. Realizimi i shpenzimeve në këtë kategori ishte rreth 99% e buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Nuk kishte të hyra të planifikuara për vitin 2025, ndërsa të hyrat e realizuara në vlerë prej 8,346€ kishin të bënin me të hyrat nga taksa administrative prej 10% nga administrimi i pronave në kuadër të skemës së qirasë.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	8,346	9,666	
Të hyrat jo tatimore	0	0	8,346	9,666	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të vitit 2024 ka rezultuar me gjithsej gjashtë rekomandime. AKKVP kishte hartuar një Plan Veprimi, në të cilin janë përcaktuar masat dhe veprimet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Deri në përfundim të auditimit tonë për vitin 2025, të gjitha rekomandimet janë zbatuar.

Zbatimi i plotë i rekomandimeve ka ndikuar në përmirësimin e proceseve të menaxhimit financiar dhe në forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Ky nivel i zbatimit reflekton angazhim dhe qasje proaktive të menaxhmentit ndaj adresimit të çështjeve të identifikuara, si dhe gatishmëri për përmirësim të vazhdueshëm.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Drejtoesha Ekzekutive duhet të sigurojë që të hyrat që i takojnë Agjencisë sipas rregullores të regjistrohen dhe të raportohen brenda periudhës përkatëse fiskale. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet e brendshme për identifikimin dhe regjistrimin e saktë të të hyrave në kohën e duhur.	Ky rekomandim është zbatuar për faktin se Entiteti kishte ndërmarr veprime duke regjistruar të hyrat dhe kishte raportuar ato në periudhën përkatëse. Pra, dërgimi i shkresave në Thesar kryhet në baza mujore.	I zbatuar

2.	Pagat dhe mëditjet	Drejtoresha Ekzekutive duhet të sigurojë zhvillimin e procedurave përkatëse për plotësimin e pozitave me personel të rregullt që aktualisht mbulohen me vendime për transfere të përkohshme, në përputhje me rregulloren e re të miratuar për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.	AKKVP ka miratuar planin e rekrutimit dhe procedurat përkatëse janë duke u zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore përmes sistemit elektronik. Transferimet realizohen në pajtim me Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, brenda të njëjtës kategori profesionale. Megjithatë, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e procedurave të rekrutimit dhe lëvizjet e vazhdueshme të stafit, plotësimi i të gjitha pozitave mbetet një proces në zhvillim. Rrjedhimisht, vlerësojmë se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
3.	Pagat dhe mëditjet	Drejtoresha Ekzekutive duhet të sigurohet që angazhimi i personelit në orë jashtë orarit të bëhet vetëm pas marrjes së aprovimit paraprak me shkrim nga udhëheqësi më i lartë i institucionit dhe të shoqërohet me dëshmi të plota për vijueshmëri dhe përmbushje të detyrave. Gjithashtu, të forcohen kontrollet e brendshme për të siguruar zbatimin e saktë të rregulloreve.	Ky rekomandim është zbatuar, pasi angazhimi i stafit për punë jashtë orarit lejohet vetëm pas marrjes së aprovimit paraprak me shkrim nga udhëheqësi më i lartë i institucionit, si dhe mbështetet me dëshmi përkatëse për realizimin e punëve të paracaktuara.	I zbatuar

4.	Pagat dhe mëditjet	Drejtoresha Ekzekutive të përforcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të siguruar që çdo fazë e procesit të rekrutimit të dokumentohet dhe të ruhet në dosjen përkatëse, duke respektuar kriteret ligjore dhe standardet e transparencës.	Dokumentacioni i plotë i procesit të rekrutimit ruhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit për zyrtarët publik lidhur me pranimin në shërbimin civil. Testi me shkrim, për shkak të funksionimit të sistemit, ruhet vetëm në sistemin SIMBNJ, i cili menaxhohet nga Ministria për Digjitalizim dhe Administratë Publike. Rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
5.	Detyrimet Kontingjente	Drejtoresha Ekzekutive duhet të sigurojë se zbatohen kontrollet e brendshme gjatë raportimit të detyrimeve kontingjente në PFV, mbështetur me dokumentacion të mjaftueshëm dhe përkatës. Për çdo rast të përfshirë duhet të vërtetohet se është ende aktiv dhe përbën një rrezik të mundshëm financiar për institucionin. Gjithashtu, regjistri duhet të përditësohet rregullisht në përputhje me zhvillimet procedurale të rasteve gjyqësore.	Nga rishikimi i PVF-ve 2025 nuk janë identifikuar gabime në prezantimin e detyrimeve kontingjente. Si rrjedhojë, rekomandimi konsiderohet i zbatuar.	I zbatuar
6.	Auditimi i Brendshëm	Drejtoresha Ekzekutive të sigurojë funksionalizimin e plotë të NjAB në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale për të siguruar mbikqyrjen e duhur të proceseve lidhur me kontrollet e brendshme. Në të kundërtën të shqyrtohet mundësia e alternativave tjera për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm.	Lidhur me funksionimin e auditimit të brendshëm, NJAB ka hartuar planin strategjik dhe planin vjetor për vitin 2025, ka realizuar auditimet e planifikuara dhe ka raportuar në NJQH sipas kërkesave ligjore. Rrjedhimisht, rekomandimi konsiderohet i zbatuar.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Shpresa Zenelaj, Udhëheqëse e ekipit



Mimoza Morina, Anëtare e ekipit



Kaltrina Neziri, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mangësi në procedurat e prokurimit për angazhimin e kontraktorëve individualë për shërbime të veçanta	<p>Neni 52 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton se kriteret e vlerësimit duhet të jenë të matshme dhe të dallohen nga kriteret e përzgjedhjes, ndërlidhet me nenin 51 të LPP-së, i cili rregullon aftësitë profesionale, financiare dhe teknike të operatorëve ekonomikë në kuadër të procedurave standarde të prokurimit publik. Megjithatë, në rastin konkret kemi të bëjmë me procedura për angazhimin e kontraktorëve individualë për shërbime të veçanta, të zhvilluara sipas nenit 57 të Rregullores për Prokurimin Publik (RRPP). Për këtë kategori të procedurave, neni 57 i RRPP-së përbën dispozitë specifike (lex specialis) në raport me rregullat e përgjithshme të procedurave standarde të prokurimit publik.</p> <p>Sipas nenit 57.5 të RRPP-së, për këto procedura mund të ofertojnë vetëm persona fizikë, pa detyrim për të pasur biznes të regjistruar, çka e dallon këtë procedurë nga procedurat standarde të prokurimit për operatorë ekonomikë. Në këtë kuadër, kriteret e përzgjedhjes janë përcaktuar me qëllim të sigurimit të kapacitetit minimal profesional të kandidatëve, në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve të kërkuara. Ndërsa, procesi i vlerësimit është zhvilluar në përputhje me nenin 57.14 dhe 57.16 të RRPP-së, ku përcaktohet se vlerësimi i tenderëve për shërbime të veçanta duhet të marrë parasysh, ndër të tjera, përvojën përkatëse, metodologjinë e propozuar,</p>	<p>Pas shqyrtimit të komenteve të entitetit, vlerësojmë se argumentimi i dhënë nuk e ndryshon konstatimin e paraqitur në gjetje. Fakti që neni 57 i Rregullores për Prokurimin Publik rregullon procedurat për kontraktimin e kontraktorëve individualë dhe lejon pjesëmarrjen e personave fizikë, nuk nënkupton përjashtim nga kërkesat e nenit 52 të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me kriteret e dhënies së kontratës.</p> <p>Përveç nenit 52 të LPP-së, edhe Rregullorja për Prokurimin Publik nr. 001/2022 dhe Udhëzuesi nr. 002/2024 kërkojnë që, në rastet kur aplikohet kriteri “Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm”, kriteret dhe nën-kriteret e vlerësimit të jenë të përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit, të formulohen në mënyrë objektive dhe të matshme, të kenë peshë dhe metodologji të qartë të pikëzimit, si dhe të mundësojnë krahasim transparent dhe të drejtë ndërmjet ofertave. Po ashtu, kërkohet qartë që kriteret e dhënies të mos mbivendosen me kriteret e përzgjedhjes.</p> <p>Në asnjë dispozitë të LPP-së, Rregullores apo Udhëzuesit nuk përcaktohet se procedurat për shërbime të veçanta përjashtohen nga këto kërkesa. Neni 57.7 i Rregullores vetëm përcakton se për kontraktorët individualë përdoret kriteri “Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm”, por nuk specifikon përjashtim nga rregullat dhe kriteret që duhet të zbatohen kur përdoret ky kriter.</p>

kualifikimet dhe elementet tjera relevante.

Po ashtu, neni 57.16 përcakton në mënyrë tabelare kriteret dhe peshat orientuese të vlerësimit teknik, duke lejuar përshtatjen e tyre sipas natyrës së prokurimit specifik. Rrjedhimisht, përfshirja e përvojës dhe kualifikimeve në fazën e vlerësimit nuk është trajtuar si përsëritje mekanike e kriterëve të përzgjedhjes, por si zbatim i kërkesave specifike të nenit 57 të RPP-së, ku këto elemente shërbejnë si kriter minimal kualifikues dhe si element konkurrues në procesin e pikëzimit teknik.

Sa i përket vërejtjeve lidhur me parametrat e pikëzimit dhe nivelin e detajimit të kriterëve matëse, pranojmë se ekziston hapësirë për avancim dhe qartësim më të madh në hartimin e dosjeve të tenderit, me qëllim të standardizimit edhe më të mirë të metodologjisë së vlerësimit në procedurat e ardhshme.

Lidhur me angazhimin e kontraktorëve individualë për pozita që ndërlidhen me rregulloren e brendshme të sistematizimit të vendeve të punës, sqarojmë se vlerësimi i nevojës dhe konfirmimi përkatës realizohen nga njësitë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, ndërsa Divizioni i Prokurimit ka vepruar në bazë të kërkesave dhe konfirmimeve të pranuar nga njësitë kompetente, në përputhje me kërkesat e nenit 57 të RPP-së.

Bazuar në sa më sipër, rekomandimi pranohet pjesërisht në aspektin e nevojës për avancimin dhe qartësimin e kriterëve matëse të vlerësimit, ndërsa vlerësojmë se procedurat në fjalë janë zhvilluar në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Prandaj, përdorimi i përvojës, dhe kualifikimit si elemente të vlerësimit teknik mund të jetë i lejueshëm vetëm nëse këto kriterë janë të ndara qartë nga kriteret e përzgjedhjes dhe janë të formuluar në mënyrë të matshme dhe objektive. Në rastet e audituara, këto elemente janë përdorur njëkohësisht si kërkesa kualifikuese dhe si kriterë të dhënies, pa parametra të qartë të pikëzimit, pa intervale të përcaktuara dhe pa metodologji të mjaftueshme për krahasimin objektiv të ofertave. Për më tepër, argumenti se këto procedura dallojnë nga procedurat standarde të prokurimit për shkak se mund të aplikojnë persona fizikë, nuk e adreson thelbin e gjetjes. Gjetja nuk konteston përdorimin e procedurës sipas nenit 57, por mungesën e ndarjes së qartë ndërmjet kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterëve të dhënies, si dhe mungesën e parametrave të matshëm të vlerësimit. Si rrjedhojë, komenti i entitetit nuk ofron bazë ligjore që do të arsyetonte përjashtimin nga kërkesat e nenit 52 të LPP-së dhe dispozitave përkatëse të Rregullores dhe Udhëzuesit për Prokurimin Publik, andaj gjetja mbetet e qëndrueshme. (Ref: Neni 52 i LPP-së, nenet 27.7, 27.9, 27.10, 45.26 dhe 45.27 të Rregullores për Prokurimin Publik nr 001/2022, si dhe pikat 9.4-9.12 të Udhëzuesit nr. 002/2024 për Prokurimin Publik).

Leterkonfirmimi



AGJENCIA KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS
KOSOVSKA AGENCIJA ZA UPOREDIVANJE I VERIFIKACIJU IMOVINE
KOSOVO PROPERTY COMPARISON AND VERIFICATION AGENCY



Për verifikim të pronës private • Za verifikaciju privatne imovine • For private property verification

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

Nr. Prot.	19-05-2026
Br. Spisane	48
Nr. i Kopjeve	5
Br. i Klasifikimit	
Nr. i Klasifikimit	
Br. i Klasifikimit	
Nr. i Klasifikimit	

DATE: PRANUAR/DORZUAR			
DATE: PRIMALJE/ODOSTAVLJEN			
DATE: RECEIVED/SUBMITTED			
15.05.2026			
Njësia Org	Sht. Klasif	Nr. Prot	Nr. i Faqeve
Org. Unit	Klasif. Kod	Prot. No.	De. Stranica
01	47	87/26	05

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- me të gjeturat dhe rekomandimin nga Çështja A1 – Pajtohem Pjesërisht, ndërsa Pajtohem lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet nga Çështja A2 dhe Çështja A3. Komentet janë dhënë tek Shtojca I/Tabela.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.
-



Afërdita Beke Arifaj
Drejtoare e Sekretarisë Ekzekutive
Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Prishtinë, 15.05.2026

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ • RI-TENDER LOT-1 Konsulent Kontraktor Individual për përgatitjen e PSO-së për Divizionin e IT (AKKVP) dhe LOT-3 Konsulent Kontraktor Individual për përgatitjen e PSO-së për përdorimin e Aplikacionit të Krahasimit të Dokumentacionit Kadastral • LOT-1 Konsulent Kontraktor Individual për përgatitjen e PSO-së për Divizionin e IT (AKKVP), LOT-2 Konsulent Kontraktor Individual për vlerësimin e Softuerit për Krahasim dhe Verifikim të Dokumentacionit Kadastral dhe LOT-3 Konsulent Kontraktor Individual për përgatitjen e PSO-së për përdorimin e Aplikacionit të Krahasimit të Dokumentacionit Kadastral • Konsulent Kontraktor Individual për dixhitalizim dhe analizë të të dhënave • Shërbime të veçanta (Konsulent Kontraktor Individual) për integrimin e infrastrukturës kompjuterike për (AKKVP) • RI-TENDER: Shërbime të veçanta (Konsulent Kontraktor Individual) për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për nevojat e AKKVP • Konsulent Kontraktor Individual - Ekspert Ligjor (AKKVP)
- ⁶ Rregullore nr. 01/2024 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Neni 11 - Divizioni Ligjor, Neni 16 - Divizioni për Komunikim me Publikun dhe Neni 22 - Divizioni i Teknologjisë Informative.
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.